

INFORMATA MBI GRANTIN

Instrumenti:	Grant Institucional
Subjekti zbatues:	Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim - ORCA
Kontaktet (adresa, emaili, telefoni, website):	Rruga Henrik Baric nr 6, Prishtinë, Kosovë, 10000 +38345234994 www.orca-ks.org info@orca-ks.org orca.comms@gmail.com
Kohëzgjatja e grantit:	Data e fillimit: 01/01/2021 Data e përfundimit: 31/12/2023
Buxheti total i grantit (EUR):	640,657.00 EUR
Buxheti i mbështetur nga programi EJA Kosovë (EUR):	114,650.00 EUR
Grupet e synuara:	Të rinjtë Stafi akademik/menaxhues të universiteteve Zyrtarë nga institucione të arsimit
Shtrirja gjeografike:	Kosovë
Përmbledhje e grantit:	Ky grant synon demokratizimin e hapësirës universitare në Universitetin e Prishtinës, duke revitalizuar organizmin studentor që do të çojë në angazhimin e studentëve në një jetë aktive në jetën publike në përgjithësi dhe universitare në veçanti. Po ashtu, synon që monitorimet dhe hulumtimet ekzistente të organizatës t'i fuqizojë me metoda të demokracisë pjesëmarrëse. Kjo synohet të arrihet: përmes themelimit të Qendrës për Aktivizmin Studentor e cila do të shërbejë si vatër e aktivizmit studentor dhe e krijimit të nismave të reja studentore; përmes themelimit të një platforme mediale studentore që merret me arsim, ku gazetës së shtypur satirike të studentëve "Tempulli i Dijes", i shtohet edhe ueb faqja e cila përveç informimit do të shërbejë edhe si platformë diskutimesh; përmes metodave të demokracisë pjesëmarrëse - avokimit institucional duke ushtruar gjyqësinë strategjike, apo edhe duke sinjalizuar publikisht përmes aksioneve simbolike e protestuese për probleme të veçanta që përbëjnë fenomene negative në sferën e arsimit të lartë.

Bashkëfinancuar nga: